

Pupu shkron në bankë!



Për klasën e dytë të arsimit fillor

Pupu shkon në bankë!

Fjalët kyçe:

origjina e parave, banka, puna, shpenzimet, të ardhurat, depozitimi, kredia, debit kartelë, shpërblim, dënim.

Udhëzime për punë me librin.

Para leximit: Bisedë me fëmijët:

- Keni qenë në bankë ndonjëherë? Me kë?
- Çfarë keni bërë aty?
- A e dini prej nga vijnë paratë?
- Cilat para i njihni përveç eurove?

Gjatë leximit: Bisedë me fëmijët:

- Nxitni fëmijët të flasin për atë çfarë shohin në ilustrim.
- Përdorni pyetjet: Çfarë po shihni? Pse është....? Ku ...? etj.
- Pas çdo faqeje të lexuar bisedoni për atë se çfarë ka ndodhur.
- Nxitni fëmijët të parashikojnë se çfarë do të ndodhë në faqen tjetër pa e shfletuar ende.
- Kërkoni nga fëmijët që të gjejnë fjalë të ngjashme me disa nga fjalët e reja në tekst.

Pas leximit: Bisedë me fëmijët:

- Shihni faqet 4 dhe 5: Çfarë mund të bësh me debit kartelë?
- Shihni faqet 10 dhe 11: Si quhen paratë nga Amerika dhe Anglia që Pupu dhe Pipa i kishin fituar dhuratë?
- Shihni faqet 12 dhe 13: A është më e sigurtë të ruhen paratë në shtëpi apo në bankë? Pse? Çka mund të ndodhë nëse i ruajmë paratë në shtëpi?
- Shihni faqen 14 dhe 15: Çfarë kërkoi nëna nga xhaxhi bankier?
- Shihni faqen 16 dhe 17: Çfarë shpërblimi të bën banka nëse i mbajmë paratë në bankë për një apo më shumë vite?



- Pipa, nëse ti ma jep librin e përrallave, unë do t'i jap ty ngjyrat e ujit, - i propozoi Pupu motrës.
- Nuk mjafton. Libri im është më me vlerë se sa ngjyrat e tua të ujit, - ia ktheu Pipa. - Vetëm po të ma japësh edhe stilolapsin tënd - shtoi ajo.
- Fëmijë, ju jeni duke shkëmbyer gjëra si në kohën kur nuk kishte para për t'i blerë ato, - qeshi nëna.
- Sot në shkollë ne mësuam për metalet. Mësuesja na tregoi, se pa metale nuk do të kishte as para. Dhe njerëzit do të duhej të këmbenin mallra, sikur unë dhe Pipa tani,- shpjegoi Pupu.



- E vërtetë! Ejani tani të shkojmë në dyqan të blejmë gjërat që na nevojiten, - i ftoi babai.
- A kemi para me vete?- pyetën fëmijët duke qeshur.
- Po, kemi ca para por kemi edhe debit kartelë, - u përgjigj nëna.

Bukatore



- Ç'është debit kartela nënë? - pyeti Pupu.
- Me të mund të paguash gjëra sikur me para të gatshme, - ia ktheu babai.
- Oh po, është ajo që vendoset në aparatin tek arkat e pagesës - tha Pipa.



- Tani që mbaroi blerja e gjërave ushqimore, në radhë janë pagesat tjera, rryma, uji dhe shumë e shumë të tjera, – pëshpëriti nëna.
- Duhet kryer sa më parë,- shtoi babai.






- Nënë, sa e vështirë është të mendosh për të gjitha këto, - tha e shqetësuar Pipa.
- Po Pipa, e vështirë është. Por unë dhe babi i kemi planifikuar të gjitha me kujdes dhe mund t'ia dalim – e qetësoi nëna.



- Arkat tona janë stërmbushur. Ne duam që ju t'i merrni kursimet tona dhe t'i paguani ato çfarë kanë mbetur pa blerë, – propozoi Pupu.
- Oh fëmijë, sa të mirë që jeni! – buzëqeshi nëna. - Ju faleminderit! Paga ime dhe ajo e babit për punët që ne bëjmë, mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e familjes tonë, - shtoi nëna.



- Ne kemi ndarë edhe paratë e xhepit për ju. Ato do t'ua dhurojmë për çdo javë, - u dëgjua zëri i babait nga kuzhina. - Edhe një shumë të parave do t'ua japim për disa nga punët e shtëpisë që do t'i kryeni, - shtoi babai.
- Ju faleminderit! – thanë njëzëri Pupu dhe Pipa.



Pas disa ditësh nëna e Pupus mori fëmijët dhe shkuan në bankë.
- Me paratë që na dhuroat, ti dhe babi, arkat tona vetëm sa nuk shpërthyen – qeshi Pupu.
- Mirë, tani xhaxhi bankier, do të hapë llogari për ju dhe ju mund t'i ruani këtu kursimet tuaja – tha nëna.



- Fëmijë, makina e numërimit të parave, po tregon se ju qenkeni kursimtarë të vërtetë! Jo vetëm që keni kursyer euro, por edhe dollarë dhe funta. Ju lumtë! - i lavdëroi xhaxhi bankier.

- Po, ato na i kanë dhuruar tezja nga Anglia dhe xhaxhai nga Amerika – u përgjigjën njëzëri Pupu e Pipa.





- Tani paratë i keni të sigurta tek ne. Prindërit tuaj do t'ju ndihmojnë të tërhiqni para kur ju të keni nevojë dhe dëshirë. Kur të rriteni këtë do ta bëni vet – ua shpjegoi xhaxhi bankier.
- Sa mirë! Banka qenka si një arkë e madhe – buzëqeshi Pipa.





- Faleminderit xhaxhi bankier. Sa mirë që kemi banka të sigurta. Neve mësuesja na ka premtuar një vizitë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës gjatë Javës Ndërkombëtare të Parasë, - fliste pa u ndalur Pupu.
- Sa mirë që do të shkoni në vizitë Pupu, Banka Qendrore përkujdeset për të gjitha bankat në Kosovë. Ata organizojnë aktivitete të ndryshme edukative, - foli xhaxhi bankier.





- Pipa dhe Pupu, tani e kam radhën unë të flas me xhaxhin bankier, - tha nëna. – Pasi që fëmijët janë rritur, ne kemi vendosur, t’ju blejmë shtretër dhe dollap të ri rrobash. Kemi menduar të marrim hua nga banka juaj për këtë, – shpjegoi kërkesën e saj nëna.

- Patjetër zonjë! Tani do t’i përgatisim dokumentet dhe pas nënshkrimit ju mund t’i merrni paratë sapo të kalojnë në llogarinë tuaj, – tha xhaxhi bankier.





- Oh, banka jo vetëm që ruan para, ajo edhe të huazon para, - u çudit Pipa.
- E pse duhet nënshkrimi? – pyeti me kureshtje Pupu.
- Nënshkrimi tregon se ti je ai që ke deponuar apo huazuar para dhe që ti do t'i marrësh apo do t'i kthesh ato në kohën e caktuar dhe me kushte të caktuara, – tha xhaxhi bankier.



- Tani paratë janë gati dhe ju mund t'i tërhiqni, - tha xhaxhi bankier.
- E nëse nuk arrijmë t'i kthejmë paratë, çfarë do të ndodhë? – pyeti Pupu serioz.
- Kjo nuk do të ndodhë me siguri, por nëse ndodhë, banka do të kërkoj një pagesë shtesë të paraparë me ligj, – shpjegoi duke qeshur xhaxhi bankier.
- Oh fëmijë, mjaft me pyetje. Ju faleminderit! Mirupafshim! – u përshëndetën me xhaxhin bankier.







- Më pëlqeu shumë xhaxhi bankier. Dua edhe unë të bëhem bankier e t'i tregoj fëmijëve për rëndësinë e kursimit të rregullt të parave, - tha Pupu pasi u kthye në shtëpi.



Titulli: "Pupu shkon në bankë!"
Hartoi tekstin: Luljeta Rama
Ilustroi: Leopard Cana

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

0875

821.18-93-34

Rama, Luljeta

Pupu shkon në bankë! / hartoi tekstin Luljeta Rama; ilustroi Leopard Cana. - Prishtinë :
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2020. – 20 f. : ilustr. ; 22 cm. - (Libri i dytë)

1.Cana, Leopard

ISBN 978-9951-8977-5-4

E drejta e autorit i përket Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nëse përdorni pjesë të këtij botimi, ju lutemi të citoni burimin.
Realizimi i këtij libri u mbështet nga EFSE Departamenti për Zhvillim.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Adresa: Rr. Garibaldi, Nr. 33 Prishtinë, Kosovë.
Tel: + 383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763
e-mail: info@bqk-kos.org

Pupu shkon në bankë!

Pupu në garën e vrapimit

Pupu shkon në bankë!

A do të shkojë Pupu në cirk?

Një ditëlindje më ndryshe!

Pupu ka një ide!

Libri i dytë

www.edukimifinanciar.org

Edukimi financiar për nxënësit e klasave I-V

ISBN 978-9951-8977-5-4



9 789951 897754